



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 65/2012
Prishtinë, më 23.05.2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Sala Berisha – Shala, Berat Buzhala, Visar Ymeri dhe Hashim Deshishku.

Pjesëmarrësi i ftuar: Dino Asanaj - kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Pjesëmarrëse te tjerë: Mrika Tahiri, Naim Avdiu, Avni Jashari - AKP; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja - INDEP; Florije Mehmeti - KDI, dhe Flamur Hyseni (ekspert ligjor-NDI).

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 16.05.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - Propozoi që pika e katërt: “Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-109 për Komunikimet elektronike”, të shtyhet në mbledhjen e radhës, sepse nuk kemi pranuar raportin nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 16.05.2012

Procesverbali i mbledhjes së datës 16.05.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011

Kryetari – Theksoi se, ashtu siç është paraparë në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, z. Dino Asanaj, i cili do të paraqesë një ekspozë të shkurtër për këtë Raport në Komision. Ai në vijim tha se në kuadër të Raportit të AKP-së, po ashtu edhe nga shoqëria civile, INDEP-i kemi opinione dhe sugjerime që kanë të bëjnë me këtë raport dhe pastaj do të hapim debat në lidhje me këtë çështje.

Dino Asanaj (kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit) - I njoftoi deputetët për hapat e deritashëm që ka marrë AKP-ja për përmbushjen e detyrimeve të dala nga Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe tha se për këtë çështje është arritur shumë dhe është duke u punuar në përmbushjen e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në tërësi. Pastaj në mënyrë kronologjike paraqiti hapat që ka marrë deri më tani AKP-ja në procesin e privatizimit. Ai në vijim njoftoi për procedurat e lehtësimit të privatizimit, pas aprovimit nga Kuvendi i Kosovës të tri ligjeve bazike për AKP-në, siç janë: Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre. Ai tha se këto tri ligje e kanë përshpejtuar shumë procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Kryetari – Pyeti për disa çështje që janë evidentuar në raport, siç janë ankesat e punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, që nuk janë përfshirë në listën e 20%-shit, dhe pyeti: Sa po shqyrtohen këto ankesa? Cilat kanë qenë vështirësitë për privatizim e ndërmarrjeve që ishin të komercializuara? Ndërmarrjet shoqërore të cilat janë privatizuar, a kanë përmbushur obligimet e tyre që janë të parapara me kontratë? Për shitjen e mbetjeve minerale në Trepçë, si po shkon procesi i shitjes në pjesën e Trepçës që është në veri të Mitrovicës? A keni informacion shtesë, sa janë funksionale minierat? Dhe për minierën e Artanës, a është duke u punuar në këtë drejtim për rivitalimin e saj?

Teuta Sahatqija - Në raport thuhet se në 82 ndërmarrje shoqërore, punëtorëve u janë shpërndare mjetet e 20%-shit që ju takojnë me privatizimin e ndërmarrjeve, por tani si po shkon ky proces? Për privatizimin e ndërmarrjeve me spin - off special si qëndron tani statuti i tyre, pasi që nuk iu kanë përmbajtur obligimeve të parapara me kontratë dhe, cilat do të jenë procedurat e më tutjeshme për riprivatizim? Si po shkon procesi i privatizimit për ndërmarrjet që janë jashtë moratoriumit të Trepçës? Cili është tani statusi i ndërmarrjeve të Gjakovës, a do të shkohet me privatizim e këtyre ndërmarrjeve?

Biserka Kostić – Bëri disa pyetje lidhur me komunitetin serb që nuk është përfshirë në listat e 20%-shit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore që po privatizohen. Dhe, për këtë mori si shembull personal babanë e saj që nuk është përfshirë fare në listë. Tha se në këtë aspekt komuniteti serb është i diskriminuar dhe ka punëtorë serbë që nuk u shqyrtohen kërkesat e tyre dhe pyeti se a merren parasysh ankesat individuale të komunitetit serb. Në ueb-faqen e AKP-së, pse nuk publikohen me kohë informatat në gjuhën serbe, por vetëm në gjuhën shqipe? Këtu nuk po respektohet dygjuhësia që është e rregulluar me Ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

Ramiz Kelmendi – Pyeti: A ekziston mundësia që AKP-ja t'ua mundësojë bizneseve të vogla privatizimin e parcelave të vogla? Për ndërmarrjet që janë privatizuar, a ekziston ndonjë ligj apo mekanizëm që t'ju mundësohet rikthimi i objekteve, nëse nuk ka kompania që ka privatizuar mjete për të investuar? Propozoi që ndërmarrjeve prodhuese që janë privatizuar, t'u lejohet që mjetet e pagesës t'i bëjnë në disa faza, në fillim të paguhet vetëm kësti prej 25%, pastaj faza e tjetër e këstit prej 75% t'u mundësohet pasi që të fillojnë punën në prodhim.

Lutfi Zharku – Pyeti: A ka AKP-ja plane se kur mund ta përfundojë në tërësi procesin e privatizimit?

Myzejene Selmani – Kërkoi nga përfaqësuesi i AKP-së që të jenë shumë më të angazhuar rreth parandalimit të keqpërdorimeve gjatë privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Pasi që Kuvendi i Kosovës i ka aprovuar ligjet që rregullojnë çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, ju si AKP duhet t'ua mundësoni dhe garantoni investitorëve një garë fer, konkurrencë të plotë dhe të lirë.

Dino Aanaj - (kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit) -Iu përgjigj pyetjeve që bënë anëtarët e Komisionit. Sa i përket shpërndarjes së 20%-shit për punëtorët e ish-ndërmarrjeve shoqërore, ai tha se janë duke e bërë shpërndarjen në bazë të Ligjit të AKP-së, duke ua mundësuar që shumica prej 20% t'ju shpërndahet pjesërisht, ndërsa pjesa tjetër e mbetur është lënë për ankesat e punëtorëve që kanë mbetur jashtë listës së 20%-shit. Për çështjen e punëtorëve serbë që nuk janë përfshirë në listën e 20%-shit, tha se listën e punëtorëve për pagesën e 20%-shit e marrin nga sindikata e ndërmarrjeve, pastaj brenda AKP-së është një departament që merret me shqyrtimin e listave të 20%-shit. Po ashtu, në kuadër të departamentit ka të punësuar edhe punëtorë serbë, në bordin e AKP-së është një anëtar serb dhe, në këtë aspekt, nuk ka ndonjë diskriminim për asnjë komunitet. Sa i përket çështjes së ueb-faqes, tha se këtu mund të ketë vonesa të publikimeve të informatave në gjuhën serbe, derisa të bëhen përkthimet në gjuhën serbe, ndërsa për këtë çështje do ta shqyrtojmë mundësinë e punësimit të një përkthyesi në gjuhën serbe. Gjithashtu, AKP-ja ka hapur edhe zyra nëpër vendet ku janë të banuar me popullatë me shumicë serbe, si: në Graçanicë, Shtërpçë dhe Leposaviq.

Naim Avdiu (Agjencia Kosovare e Privatizimit) Iu përgjigj pyetjes për ndërmarrjet e komercializuara. Ai tha që gjatë vitit 2011 janë monitoruar tri ndërmarrje që kanë pasur prona shoqërore me qira. Të gjitha ndërmarrjet e komercializuara kanë pasur obligime me kontratë ndaj AKP-së, prandaj gjatë monitorimit është konstatuar se disa prej tyre pjesërisht i kanë kryer obligimet e parapara me kontratë dhe tani AKP-ja është e obliguar që t'i fillojë procedurat e privatizimit për këto ndërmarrje që kanë hapësira dhe objekte shoqërore, duke i shfrytëzuar me qira. Shumë shpejt pritet që edhe këto ndërmarrje shoqërore të dalin në privatizim.

Mrika Tahiri (Agjencia Kosovare e Privatizimit) Iu përgjigj pyetjes për administrimin e ndërmarrjeve shoqërore. Tha se këto ndërmarrje janë të mbikëqyrura nga AKP-ja sesi po menaxhohen, por menaxhohen vetë nga punëtorët e ndërmarrjes, që janë të obliguar t'ju përmbahen kushteve të parapara me rregulloret e AKP-së deri në fazën e privatizimit.

Dino Asanaj - (kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit)- Theksoi se lidhur me pyetjet për Trepçën, tha se për pjesën e Trepçës që është në pjesën verore, kemi informata të mira që mund të fillojmë bashkëpunimin edhe me stafin menaxhues në atë pjesë. Për ndërmarrjet që nuk janë nën moratoriumin e Trepçës tha se tani disa prej tyre kanë nisur të dalin në privatizim, siç është Fabrika e Baterive në Pejë dhe shumë shpejt pritet të privatizohen këto ndërmarrje të ndara nga Trepça. Për shitjen e mbeturinave tha se është shpallur tenderi. Në këtë rast po i shikojmë praktikën më të mirë ndërkombëtare të tenderëve në këtë sektor, sepse kanë mbetur sasi të mëdha të mbeturinave që mund të përmbajnë metale, prandaj ka interesim të madh edhe nga kompanitë e huaja për blerjen e këtyre mbeturinave. Për likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore, ai tha se pas miratimit të Ligjit për riorganizimin të ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, në bazë të rregullores së AKP-së, është duke u punuar në këtë proces që po ecet shumë më shpejt. Për mosrezultatit të ndërmarrjeve që janë privatizuar, theksoi se këtu kemi të bëjmë me një konkurrencë shumë të madhe, prandaj është çështje e kompanive që kanë bërë privatizimin sesi ta gjejnë tregun në këtë konkurrencë të madhe.

Për arsye të takimeve të tjera, zëvendëskryetari i dytë i Komisionit, z.Fikrim Damka dhe deputetja znj. Myzejene Selmani, lëshuan mbledhjen. Në mungesë të kuorumit, kryetari e mbylli mbledhjen e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit